

PËRMBLEDHJE JOTEKNIKE E RAPORTIT TË VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

SHFRYTËZIM I MINERALIT RANOR KONGLOMERATIK.

**(SIPAS LIGJIT NR. 10440, DATË 07.07.2011, “PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË
MJEDIS”, SHTOJCA 2, PIKA 2. 1. GURORË, MINIERA SIPËRFAQËSORE DHE
NXJERRJE E TORFËS)**

LEJA MINERARE NR. 1200/2, OBJEKTI “LEKAJ”, QARKU TIRANË.



**KERKUES:
SHOQËRIA “SIMONI&VEZA” SHPK**

**Administratori:
Z. Orgert Çurumi**

Shkurt, 2022

PËRMBAJTJA

- A) NJË PËRSHKRIM TË SHKURTËR TË MBULESËS BIMORE TË SIPËRFAQES KU PROPOZOHET TË ZBATOHET PROJEKTI, TË SHOQËRUAR DHE ME IMAZHE TË MARRA JO MË VONË SE 6 MUAJ NGA DATA E APLIKIMIT; 3
- B) INFORMACION PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE NË SIPËRFAQEN E KËRKUAR NGA PROJEKTI DHE NË AFËRSI TË SAJ; 4
- C) NJË IDENTIFIKIM TË NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS TË PROJEKTIT, PËRFSHIRË NDIKIMET NË BIODIVERSITET, UJË, TOKË, AJËR; 5
- Ç) NJË PËRSHKRIM TË SHKURTËR PËR SHKARKIMET E MUNDSHME NË MJEDIS, TË TILLA SI: UJËRA TË NDOTURA, GAZE DHE PLUHUR, ZHURMË, SI DHE PRODHIMIN E MBETJEVE. 6
- D) INFORMACION PËR KOHËZGJATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE TË IDENTIFIKUARA. 7
- DH) TË DHËNA PËR SHTRIRJEN E MUNDSHME HAPËSINORE TË NDIKIMIT NEGATIV NË MJEDIS, QË NËNKUPTON DISTANCËN FIZIKE NGA VENDNDODHJA E PROJEKTIT DHE VLERAT E NDIKUARA QË PËRFSHIHEN NË TË. 7
- E) MUNDËSINË E REHABILITIMIT TË MJEDISIT TË NDIKUAR DHE MUNDËSINË E KTHIMIT TË SIPËRFAQES SË MJEDISIT TË NDIKUAR NË GJENDJEN E MËPARSHME, PËRFSHIRË EDHE TOKËN BUJQËSORE, SI DHE KOSTOT FINANCIARE TË PËRAFËRTA PËR REHABILITIMIN; 8
- Ë) MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS. 10
- F) NDIKIMET E MUNDSHME NË MJEDISIN NDËRKUFITAR (NËSE PROJEKTI KA NATYRË TË TILLË). 12

A) NJË PËRSHKRIM TË SHKURTËR TË MBULESËS BIMORE TË SIPËRFAQES KU PROPOZOHEM TË ZBATOHEM PROJEKTI, TË SHOQËRUAR DHE ME IMAZHE TË MARRA JO MË VONË SE 6 MUAJ NGA DATA E APLIKIMIT;

Per nga origjina, perberja dhe veçorite gjeobotanike bimesia e Shqiperise ben pjese ne nenzonen floristike mesdhetare e cila perfshihet ne nje njesi me te madhe, ne zonen holarktike. Ndikim te madh ne zhvillimin e flores mesdhetare ushtroi ftohja e pergjithshme e klimes ne periudhen e pleistocenit dhe akullzimi i fuqishem qe pasoi ate. Tiparet karakteristike te bimesise mesdhetare si per sa i perket veçorive gjeobotanike ashtu edhe perberjes morfologjike dhe shtrirjes vertikale te saj, jane karakteristike edhe per bimesine e vendit tone. Por kushtet konkrete te zhvillimit, sidomos te klimes dhe te relievit kane percaktuar edhe veçorite origjinale te flores se Shqiperise.

E gjithë kjo pasuri floristike i detyrohet veçorive te evolucionit paleogeografik te Shqiperise dhe sidomos larmise se madhe te klimes, copetimit te theksuar te relievit dhe formave te shumellojshme te tij, formacioneve te shumta shkembore (karbonatike, magmatike, terrigjene) etj.

Problemet e biodiversitetit perbejne aktualisht nder problemet më me rendesi ne rruzullin tokesor. Termi biodiversitet eshte shume kompleks dhe si i tille, zhvillimi dhe percaktimi i strategjive te pershtatshme per mbrojtjen e tij, shoqerohet me nje proces te veshtire zgjedhesh dhe vendimarrjesh. Biodiversiteti perben teresine e llojeve dhe ekosistemeve ne nje rajon, apo ne gjithë rruzullin tokesor. Ekosistemet jane te nje rendesie te vecante sepse ato perbejne bazat per ekzistencen e llojeve. Cenimi i tyre, si rezultat i aktiviteteve te ndryshme ekonomike shoqerore perben nje shqetesim per njerezit dhe studiuesit. Vlera e nje biodiversiteti te larte per njerezimin jepet para se gjithash nepermjet funksionit te tij si stabilizator i biosferes dhe si burim direkt i prodhimit.

Per shkak te mbizoterimit te relievit kryesisht kodrinoro-malor, qe kushtejon ndryshime te dukshme te klimes dhe te faktoreve te tjere, bimesia eshte e shkallezuar ne drejtim vertikal ne kater breza: brezi i shkurreve dhe i pyjeve mesdhetare; brezi i ahishteve dhe i haloreve dhe brezi i kullotave Alpine.

Brezi i shkurreve dhe i pyjeve mesdhetare (deri rreth 700m lartesi) gjendet ne trevat perendimore dhe jug-perendimore. Pjesen e siperme te brezit te shkurreve mesdhetare e zene shkurret qe i rrezojne gjethet gjate stines se dimrit si psh shkoza.

Siperfaqja e kerkuar per shfrytezim perfaqesohet nga bimesi e varfer dhe e rralle ne forme shkurresh. Kjo bimesi nuk ka vlera drusore, sherben per kullota duke krijuar nje peisazh te gjelberuar. Ne kodrat perreth ka bimesi shkurre gjeneshter, shkurre, ferra, murriz, drize, etj. drure frutore si ullinj dhe vreshtari te mbjella nga fermeret. Nga fermeret e zones gjithashtu kultivohen drure te ndryshem frutore si vreshta rrushi, kumbulla, fiq, pjeshka, qershi, ullishte dhe bime per prodhim drithi, foragjere, zarzavate etj.

Gjithashtu ne siperfaqen e objektit ne shfrytezim nuk ka zona të mbrojtura dhe monumente natyrore.



B) INFORMACION PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE NË SIPËRFAQEN E KËRKUAR NGA PROJEKTI DHE NË AFËRSI TË SAJ;

Zona në të cilën ndodhet objekti i shfrytëzimit të mineralit ranor konglomeratik nuk ka ujëra sipërfaqësore dhe nëntokësore. Brenda kontureve të vendburimit s'ka burime uji dhe nuk parashikohet shfaqja e tyre gjatë kryerjes së punimeve të shfrytëzimit.

Burimi ujor më i afërt me objektin në shfrytëzim është Perroi i Ukajt i cili ndodhet në një distancë rreth 350m në jug të tij.

Burimet në zonë kanë prurje të vogël dhe dalin kryesisht në prerjet erozive të perrenjeve e lumenjeve. Regjimi i tyre pëson ndryshime të mëdha nga stina e lagët në stinën e thatë. Varferia e botes bimorë dhe mungesa e sipërfaqeve të pyllëzuara, bën që ujërat e reshjeve të mos kapen dhe mbahen nga vegjetacioni i ulet dhe rrenjet e bimëve të lenë me pas vendin infiltrimit të ujit në netokë.

Varferia e botes bimorë bën gjithashtu të mundur që avullimi i ujit nga toka pas reshjeve të jetë i madh duke zvogëluar në këtë mënyrë infiltrimin dhe shtimin e sasisë së ujërave nëntokësore.

Në shtretërit erozivë – karstikë të perrenjve të vegjël të kësaj zone vërehen edhe disa burime të vogla të cilat përbejnë daljet e vetme të dukshme të ujërave nëntokësore rreth zonës në fjalë. Këto burime kanë shumë pak ujë dhe sasia e tij gjatë vitit pakesohet.

Foto te burimeve ujore



C) NJË IDENTIFIKIM TË NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS TË PROJEKTIT, PËRFSHIRË NDIKIMET NË BIODIVERSITET, UJË, TOKË, AJËR;

Zona ne shfrytezim nuk përfaqëson zone me rëndësi të veçantë dhe për këtë arsye nuk është parashikuar sipas Strategjisë për “Ruajtjen e Biodiversitetit dhe Planit të Veprimit si Zonë e Mundëshme” për tu shpallur “Peizazh i mbrojtur”. Ajo është shpallur si zone minerare për shfrytezim.

Nga veshtrimi i projektit të propozuar dhe përvoja shumë vjecare të këtyre projekteve në këto zone po japim një identifikim të mundshëm:

1- Ndikimi i faunes në zone

Siperfaqja në të cilën ndodhet objekti i shfrytëzimit është e varfër në bimesi dhe rrjedhimisht proceset ekologjike janë minimale dhe të kufizuara. Fakti që në zone zhvillohen shumë aktivitete të ngjashme, na jep të drejtë të themi se nuk kemi ndonjë shtim apo demtim habitati të ekosistemesha të virgjera. Disa procese që lidhen me shumë me shqetësimet dhe cilësinë e mjedisit, ushtrojnë ndikimet e tyre në botën e gjallë sidomos mbajnë larg zonës disa lloje shtazore.

2- Ndikime në peisazh dhe topografinë e terrenit ku ndodhet objekti

Ndër ndikimet më evidente janë ndryshime të përrësive të terrenit dhe ato vizuale të peisazhit. Gjithashtu ndikime ka edhe në zhvillimin e proceseve të tokeformimit etj, në sipërfaqen e prekur.

3- Identifikimi i ndikimeve te mundshme negative ne ajer dhe zhurmat

a- Shkarkim i sasise minimale te gazeve nga automjetet

Sasia e gazeve NO₂ dhe SO₂ qe shkarkohet eshte standard i teknologjise se automjeteve qe perdoren gjate punimeve te parashikuara.

b- Emetim zhurmash nga automjetet e transportit dhe mjetet e punes.

Objekti eshte i distancuar nga qendrat e banuara, keshtu qe rritja e nivelit te zhurmave nuk krijon probleme per banoret, vetem per faunen. Gjithsesi operacionet e punes jane te limituara ne kohe.

c- Sasi pluhuri si pasoje e proceseve te punes, qarkullimit te kamioneve jashte objektit dhe transportit te mineralit.

Ky fenomen eshte me i dukshem gjate stines se thate, ne sasi te limituara per shkak te volumit te punimeve dhe mund te shqetesoje kryesisht faunen ne zone, pasi qendrat e banuara ndodhen larg objektit ne shfrytezim.

4- Ndotja ne toke

Persa i perket ndotjes se tokes gjate zhvillimit te aktivitetit mund te jete aksidentale nga derdhja e karburanteve qe perdorin makinat dhe mjetet e germimit. Ne karriere mjetet qe perdoren kontrollohen here pas here per rrjedhje te karburantit dhe vajrave dhe te eliminohen ato. Toka e germuar si sterile grumbullohet ne sheshin e depozitimit te sterileve te caktuar sipas projektit ne shfrytezim. Ne kete shesh duhet mbrojtur me kanale periferike te cilet bejne mbrojtjen nga erozioni te materialit te germuar. Germimi i tokes nuk ndote ambjentin sepse nuk clirohet asnje lloj gazi.

5- Ndotja ne ujera

Ne vendburim nuk parashikojme te dalin ujera. Ky objekt nuk prek burimet ujore te zones. Nuk perdor ujin gjate proceseve te punes. Kurse ne siperfaqe ku zhvillohet aktiviteti mund te kete ndotje te derdhjeve padashje te vajrave dhe karburantet e automjeteve.

Ç) NJË PËRSHKRIM TË SHKURTËR PËR SHKARKIMET E MUNDSHME NË MJEDIS, TË TILLA SI: UJËRA TË NDOTURA, GAZE DHE PLUHUR, ZHURMË, SI DHE PRODHIMIN E MBETJEVE.

Çdo aktivitet qe zhvillohet ne mjedis shoqerohet me pasoja dhe ndikime ne mjedis qe jane pjese e atij kompromisi qe shoqeria jone ka zgjedhur per t'u zhvilluar. Megjithate e rendesishme eshte qe te kuptohet natyra e ketyre proceseve, forma e shfaqjes se tyre dhe me analitikisht ndikimet e çdo operacioni te kryer, sidomos mbi burimet natyrore te parinovueshme.

Industria minerare eshte shume e rendesishme ne ekonomine e nje vendi, por ajo shoqerohet edhe me ndikime mjedisore negative te cilat ne disa raste mund te jene te pashmangshme. Shume prej ndikimeve negative mjedisore mund te minimizohen permes nje planifikimi te kujdesshem mjedisor dhe aplikimit te teknikave dhe teknologjise se parandalimit te ndotjeve.

Ujerrat e ndotur

Ne vendburim nuk parashikojme te dalin ujera. Nuk perdoret uje gjate proceseve te punes. Ky objekt nuk prek burimet ujore te zones. Kurse ne siperfaqen ku zhvillohet aktiviteti mund te kete ndotje te derdhjeve padashje te vajrave dhe karburantet e automjeteve.

Perdorimi i ujit ne kete objekt eshte vetem gjate muajve te veres per lagjen e territorit dhe minimizimin e sasive te pluhurit ne atmosfere.

Gazet

Referuar natyres se procesit nuk kemi sasi gazesh te shkarkuar ne atmosfere. Gazet prej mjeteve te punes jane ne intervale kohore te shkurtra, brenda normave te lejuara pa ndonje ndikim negativ ne mjedisin perreth. Këto lloj mjetesh emetojnë sasira gazesh të cilat janë rezultat i punës së motorrave me djegie të brendshme, brënda normave të lejuara. Këto mjete para se të vihen në punë janë objekt i kontroleve teknike vecanërisht për emetimet e gazta.

Pluhuri

Operacionet e punes mund të gjenerojnë një sasi të konsiderueshme pluhuri çdo ditë, si rezultat i proceseve të prerjes se mineralit ranor konglomeratik dhe automjeteve që udhëtojnë rreth zones. Në varësi të përbërjes së mineralit, mund të gjendet në grimcat e ajrit, duke buruar nga vetë minerali. Për të lehtësuar ekspozimin ndaj grimcave të ajrit, rekomandohet përdorimi i procesit të lagies se rruges dhe perreth siperfaqeve ne ambientin e punes për eliminimin e pluhurave. Lagia e rruges të aksesit dhe ambienteve të punës duhet te behet me një bot uji, i cili duhet të jetë gjithmonë prezent në kantier.

Zhumra

Zhurmat e krijuara jane gjate proceseve te punes, nga makinerite per nxjerrjen e mineralit ranor konglomeratik dhe makinerive te transportit. Burimet e zhurmave jane ne siperfaqe. Cdo burim perhap vale zhurme. Fusha akustike qe rezulton varet nga karakteristikat e absorbimit dhe reflektimeve te te gjitha pengesave ekzistuese, ndermjet burimit dhe receptorit. Energjia zvogelohet pergjate rruges si rezultat i absorbimit te siperfaqeve, divergjences gjeometrike dhe absorbimit atmosferik.

Prodhimi i mbetjeve

Shfrytezimi i ketij objekti nuk gjeneron mbetje te rrezikshme. Mbetjet strile qe gjenerohen nga shfrytezimi, jane pjesa vegjetale e kores se tokes ne nje trashesi mesatare 0.3m-0.5m dhe jane te pademshme ne ambientin perreth. Mbetje sterile qe dalin nga procesi i shfrytezimit te mineralit shfrytezohen per rehabilitimin e tokes.

D) INFORMACION PËR KOHËZGJATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE TË IDENTIFIKUARA.

Ndikimet negative të identifikuara me lart do te jene gjate gjithë kohes se zhvillimit te ketij aktiviteti. Ato mund te jene me te dukshme gjate stines se veres pasi edhe mundesia e shkarkimeve ne kete periudhe eshte me e madhe. Megjithate duhet theksuar se proceset e punes jane ne nje kohezgjatje jo te madhe dhe shkarkimet ne mjedis jane minimale.

DH) TË DHËNA PËR SHTRIRJEN E MUNDSHME HAPËSINORE TË NDIKIMIT NEGATIV NË MJEDIS, QË NËNKUPTON DISTANCËN FIZIKE NGA VENDNDODHJA E PROJEKTIT DHE VLERAT E NDIKUARA QË PËRFSHIHEN NË TË.

Siperfaqja ku kryhen punimet per shfrytezimin e mineralit ranor konglomeratik eshte e varfer ne bimesi dhe rrjedhimisht proceset ekologjike jane minimale dhe te kufizuara. Disa procese qe lidhen me shume me shqetesimet dhe cilesine e mjedisit, do te ushtrojne ndikimet e tyre ne boten e gjalle sidomos do te mbajne larg zones disa lloje shtazore. Objekti eshte i distancuar nga qendrat e banuara, keshtu qe rritja e nivelit te zhurmave nuk krijon probleme per banoret, vetem per faunen. Gjithsesi operacionet e punes jane te limituara ne kohe.

Sasia e gazeve NO₂ dhe SO₂ qe shkarkohet eshte standard i teknologjise se automjeteve qe perdoren gjate punimeve te parashikuara jane te limituar ne kohe dhe nuk ka ndikime ne banoret e fshatit Lekaj, qe eshte edhe qendra me e afert e banuar ne nje largesi prej rreth 450m nga objekti.

Rrjedhimisht mund te themi se ndikimet ne mjedis do te zgjasin per nje periudhe kohore aq sa do te kete aktivitet ne terren. Pas perfundimit te ketij aktiviteti, subjekti duhet te zbatoje planin e rehabilitimit te siperfaqeve te demtuara, duke i shnderruar ato ne mjedise dhe peizazhe ne perputhje me natyren.

E) MUNDËSINË E REHABILITIMIT TË MJEDISIT TË NDIKUAR DHE MUNDËSINË E KTHIMIT TË SIPËRFAQES SË MJEDISIT TË NDIKUAR NË GJENDJEN E MËPARSHME, PËRFSHIRË EDHE TOKËN BUJQËSORE, SI DHE KOSTOT FINANCIARE TË PËRAFËRTA PËR REHABILITIMIN;

Rehabilitimi i tokes

Per rehabilitimin e tokes, do te shfrytezohen mbetjet e imeta nga materiali i nxjerre dhe do te plotesohet me dhera humusore te pasur me pleh. Nese do te nevojitet stabilizimi i ketij dheu nje pjese e faqes se pjerret do te behet me trugje te ngulura me thellesi 30 cm, mulcirimi do te jete i thate dhe me kashte, gjethe te bimeve te zones dhe dege. Mulcirimi do te sherbeje si per uljen e humbjeve te farnave nga largimi prej aktivitetit eolik, ashtu dhe per uljen e aktivitetit erodik per sa kohe vegjetacioni eshte i pa zhvilluar mire. Mbjelljet do te kene renditjen me largesi fidanesh cdo 10 m, gje qe do ti jape nje kurore dendesi mjaft e mire territorit pas shfrytezimit, dhe lejon dritezimin per veterritjen dhe zhvillimin e bimeve natyrore.

Rehabilitimi i plote i mjediseve te territorit do te jete si me poshte:

-Mbjellja e tarracave

-Mbjellje e taracave ne shkallet e karrieres

-Filiza 2 vjecare ne periferi

-Mbjellje e filizave 2 vjecare te pemeve dhe lejimi i perteritjes se shkurreve.

Nga vete rehabilitimi i habitateve me perparesi do te marre rritja e abudances se shpendeve dhe zvarranikeve dhe njekoheesisht do te shtohen si habitatet ashtu dhe rezervat natyrore edhe per gjitaret e larte si lepuri etj. Prej ketej do te rritet edhe mundesia e pranise se mishngrenesve te larte si dhelpira etj.

-Kanalet dhe kunetat

Kunetat dhe kanalet do te bejne qe rrjedhja e ujrave siperfaqore te behet me force rendese, duke perftuar ne kete menyre grumbullimin e tyre dhe me pas depertimin gradual ne toke. Kombinimi i punimeve te shfrytezimit te karrieres me ato te zbutjes se impakteve mjedisore si dhe punimet rehabilituese, do te kete si pasoje edhe rritjen e numrit te te punesuarve. Kujdesi per punimet rehabilituese nga ana e shoqerise do te vazhdojne te pakten deri ne kater vite pas mbarimit perfundimtar te shfrytezimit te karrieres.

-Krijimin e siperfaqeve per mbjellje, sistemimin, grumbullimi dhe mbjellja

Per te krijuar siperfaqet per mbjellje, shkurresh ose barishtesh te zones, subjekti parashikon qe ne vitin e pare te beje :

Sistemimin i dherave ne taracat e shesheve te shkalleve per te gjithë siperfaqen qe do te shfrytezohet . Ndryshimet e mundeshme ne ritmet e prodhimit do te reflektohen edhe ne planet e rehabilitimit.

-Punimet e mbylljes trajtimit te sterile dhe rehabilitimit te zones

Elementet e mesperm jane marre ne konsiderate ne hartimin e projektit te mbylljes dhe llogaritjen e shpenzimeve perkatese per realizimin e tij dhe perkatesisht

-Leja te shfrytezuara te krijuara nga shfrytezimi do te mbushen me sterilet e depozituara perreth tyre dhe me vone do te mbulohen me dhe aktiv per te mundesuara mbjelljen e pemeve te pershtatshme te zones.

-Do te çmontohen pajisjet

-Ne perfundim do te jete i shoqeruar nga sinjalistika perkates edhe rrethimi

Preventivi i shpenzimeve te rehabilitimit te siperfaqes se shfrytezuar dhe llogaritja e garancise ne vit

Tabela e shpenzime per mbylljen dhe rehabilitimin e 1 Ha

Preventivi i planit te rehabilitimit te karrieres te shfrytezuar me siperfaqe								
Nr	Operacionet	Siperfaqja	Norma	Siperfaqe	norma	Volumi punes	Çmimi	Vlera
			ha/ha	operacionil	m3/ha	m3	Leke/m3	Leke
I	Plani I mbylljes se Karrieres							
Nr	Emertimi							
a	Krehje sistemim ifaqeve anesore	1	1.5	1.5	200	300	50	15000
	Shuma I .							15000
II	Plani I menaxhimit te mbetjeve							
a	Sistemimi I mbetjeve te zbulimit	1	0.6	0.6	2000	1200	20	24000
b	Sistemimi I mbetjeve teknologjike	1	0.25	0.25	2000	2000	20	40000
	Shuma II							64000
III	Plani i rehabilitimit perfundimtar te mjedisit							
					nr/ha	nr		
a	Mbushje me dhe e siperfaqes	1	0.5	0.5	2500	1250	35	43750
b	Mbjellje pemesh	1	0.5	0.5	300	150	100	15000
c	Hapje gropash	1	0.5	0.5	300	150	100	150000
d	Blerje pemesh	1	0.5	0.5	300	150	50	7500
e	Sherbime	1	0.5	0.5	300	150	50	7500
f	Kanali I ujrave te larta		Norma		gjatesi	Volumi	Çmimi	Vlera
			ml/ha		ml	m3	leke/m3	leke
		1	300		300	75	200	15000
g	Sinjalistike							5000
	Shuma (a-g)							243750

	Shuma (I+II+III)						322750
	TOTALI						322750

Shpenzimet per mbylljen dhe rehabilitimin e 1 ha kariere per pjesen e shfrytezuar me kariere eshte **322 750 leke/ha**.

Siperfaqja qe do te preket nga shfrytezimi dhe qe do te rehabilitohet eshte 13.8 hektare:

Tabela e shpenzimeve te rehabilitimit

Nr.	Emertimi aktivitetit	Kosto rehabilitimi Leke/ha	Sasia (ha)	Shuma lek
1	Reabilitim kariere	322750	13.8	4453950leke
	Tarifa e garancise se rehabilitimit vjetore			445 395

Fazat e planifikuara te rehabilitimit te karieres pas mbarimit te funksionimit te projektit

Nr.	Emertimi	Vitet
1	Ndertim kunetash , kanale kullimi uji, sistemim skarpate dhe sheshe shkalle	Ne periudhen 01.07.2008 - 01.07.2029
2	Furnizim vendosje, shtrim te dherave humusore ne sheshet e shkalleve, hapje gropash	Ne peiudhen 01.07.2029- 30.12.2029
3	Mbjellje te shesheve te shkalleve me bar dhe bimesi	Ne peiudhen 01.07.2029- 30.12.2029
4	Sherbim te zones se reabilituar zevendesim te bimeve te demtuara	Ne periudhen 03.01.2030 – 30.12.2033

Ë) MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS.

Masat per mbrojtjen e tokes

<i>Lloji i ndikimit</i>	Masat e propozuara
<i>Largimi i shtreses aktive te tokes</i>	Sasia e dheut te germuar mund te sistemohet brenda siperfaqes se karrieres dhe te perdoret per qellime rehabilitimi ne faza te ndryshme te shfrytezimit ose per rehabilitimin e rrugeve dhe siperfaqeve te demtuara ne perfundim te shfrytezimit te karrieres.
<i>Ngjeshje e pjesshme e tokes nga levizja e automjeteve te transportit si kamione etj.</i>	Per parkimin e makinerive dhe automjeteve dhe kryerjen e sherbimeve te mirembajtjes do te shfrytezohen vendet e caktuara.
<i>Erozion siperfaqesor ne mot me reshje</i>	Do te piketohen dhe hapen kanalet e drenazhimit ne siperfaqe. Pergjate segmenteve rrugore ne varesi te terrenit dhe kushteve te tokes do te hapen kanale anesore qe do te ndalin forcen gerryese te ujerave te reshjeve, ndersa pergjate perimetrit te sheshit te depozitimit te mineralit do te hapen kanale perimetrike kufizuese qe do te frenojne gerryerjen dhe transportin e tokes sipas gradientit te pjerrtise nga ujerat siperfaqesore. Ne pjese te vecanta do te shihet mundesia e mbjelljeve te fidaneve pyjore te pershtatshem per zonen fitoklimatike.

<i>Ndotje e tokes si pasoje e avarive te mekanikes</i>	Makinerite e shfrytezimit dhe transportit do te kontrollohen per gjendjen e tyre teknike dhe nese konstatohen pjese te amortizuara qe mund te rrjedhin lubrifikante do te zevendesohen me te reja. Ne rast te ndonje aksidenti dhe rrjedhjeve aksidentale te lendeve ndotese ne mjedis do te merren masa per pastrimin e menjehershem te tokes se ndotur.
<i>Masat per mbrojtjen e ajrit</i>	
<i>Lloji i ndikimit</i>	Masat e propozuara
<i>Emetime te pluhurit, zhurmes, gazeve, aromave dhe vibracione</i>	Për të lehtësuar ekspozimin ndaj grimcave të ajrit gjate punimeve, rekomandohet përdorimi i procesit të lagjes së rruges dhe përreth sipërfaqeve në ambientin e punës për eliminimin e pluhurave. Lagia e rruges të aksesit dhe ambienteve të punës duhet të bëhet me një bot uji, i cili duhet të jetë gjithmonë prezent në kantier. Gjithashtu makinerite e ngarkim-shkarkimit, transportit duhet të mirembahen teknikisht që zurma e tyre të jete vetëm ajo teknologjike dhe jo e avarive. Ato duhet të përdoren me efikasitet dhe të minimizohet koha gjate së cilës mbahen ndezur motorët. Skapamentot duhet të kenë në gjendje funksionale filtrat e tyre teknologjike të kapjes së grimcave (skapamentot e makinerive kanë një jastek të posaçshëm për këto gjë). Do të përdoret naftë me përmbajtje të ulët squfuri. Transporti i materialeve të bëhet me mjete të pastra nga balta dhe të mbuluara nëse rruget kalojnë pranë ose nëpër qendrat e banuara. Të menjahetë renia e borive të automjeteve nga shoferet për të mos krijuar zhurmë dhe stres tek banorët. Qarkullimi i kamioneve në qendrat e banuara të bëhet me shpejtësi të ulët gjë që shmang jo vetëm aksidentet por edhe krijimin e pluhurave.
<i>Masat per mbrojtjen e peisazhit</i>	
<i>Lloji i ndikimit</i>	Masat e propozuara
<i>Ndikime ne peisazh dhe topografine e relievit</i>	Gjate shfrytezimit nuk duhet të demtohen sipërfaqe të panevojshme si pasoje e mosplanifikimit të saktë apo e neglizhencës së punetoreve që mund të presin pemë apo të shkaktojnë zjarre dhe demtojnë peisazhin dhe bimesinë e zonës.
<i>Masat per mbrojtjen e biodiversitetit</i>	
<i>Lloji i ndikimit</i>	Masat e propozuara
<i>Ndikime ne flore dhe faune</i>	Në zonën e shfrytezimit nuk ka ndonjë lloj ose specie flore apo faune që mbrohet me shtetësi të veçantë. Flora dhe fauna lokale nuk do të preket nga shfrytezimi, pasi sipërfaqja e objektit është pothuajse e zhveshur nga bimesia. Megjithatë shoferet do të udhëzohen të bëjnë kujdes gjate transportit në zonë pyjore për të mos shtypur kafshë që mund të jenë në mes të rrugës. Shoferet duhet të spastrojnë kafshët pastaj të vijojnë udhëtimin.
<i>Masat per administrimin e mbetjeve</i>	
<i>Lloji i ndikimit</i>	Masat e propozuara
<i>Gjenerim i mbetjeve nga aktiviteti njezor dhe sterilet</i>	Mbetjet e gjeneruara nga aktiviteti jetësor i punetoreve apo ambalazhet do të grumbullohen nëpër thasë të posaçshëm dhe do të transportohen drejt qendrave me të afërta të banuara për menaxhim nga sektoret përkatës të pushtetit lokal. Mbetjet sterile që gjenerohen nga shfrytezimi, janë pjesë vegjetale e kores së tokës në një trashësi mesatare 0.3m-0.5m dhe janë të pademshme në ambientin përreth. Mbetje sterile që dalin nga procesi i

shfrytezimit te mineralit do te shfrytezohen per rehabilitimin e tokes.

F) NDIKIMET E MUNDSHME NË MJEDISIN NDËRKUFITAR (NËSE PROJEKTI KA NATYRË TË TILLË).

Zhvillimi i ketij aktiviteti nuk sjell ndikimet te mundshme në mjedisin ndërkufitar. Subjekti do te kujdeset per administrimin e çdo informacioni qe lidhet me ushtrimin e veprimtarise. Administrimi i te dhenave konsiderohet shume i rendesishem per menyren e operimit te subjektit dhe do te perdoret per te permiresuar eficencen e çdo mase te parashikuar per zbutjen e ndikimeve ne mjedis dhe ne teresi. Per mbajtjen e te dhenave do te perpilohet nje regjister i veçante, fushat e te cilit te mbulojne te gjithe llojin e informacionit te mbledhur qe lidhet me aktivitetin e minieres.